



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 26, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Rregullores QRK, nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.4.2026, mori këtë

#### VENDIM

Për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim NP “Termokos”, SHA.

1. Miratohet vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës NP “Termokos”, SHA, pa procedurë të rregullt konkurrimi.
2. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij vendimi është:
  - Pjesa e parcelës kadastrale, me nr. P-71914059-07090-21, në sipërfaqe prej 18.m<sup>2</sup>.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është dhënie në shfrytëzim e pronës komunale e cila është kërkuar nga NP “Termokos”, SHA, për ndërtim të Stacionit pompues për projektin Solar 4 Kosova;
4. Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 2 të këtij vendimi, është në afat për 10 vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike;
5. Prona e paluajtshme sipas pikës 2 të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim;
6. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

7. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës;
8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës;
9. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
  - Kërkesa,
  - Kopja e planit dhe certifikata e pronës.
10. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-463/03-62810/26, më 29.4.2026**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Fehmi Kupa**



## Arsyetim

N.P. "Termokos" Sh.A, Prishtinë, përmes shkresës me numër 13-353/01-20510/26, të datës 6.2.2026, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës që të procedohet me dërgimin e propozimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, konkretisht:

- pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-71914059-07090-21, në sipërfaqe prej 18 m<sup>2</sup>.

Në Zonën Kadastrale Prishtinë, për qëllim të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në favor të N.P. "Termokos" Sh.A., Prishtinë.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është dhjetë (10) vjet, duke ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste të veçanta. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës do të përcaktohen me kontratë, e cila do të lidhet ndërmjet Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe shfrytëzuesit.

Në bazë të dispozitave ligjore të përmendura në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe dokumentacionit përkatës të lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.